



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr. 60/01-3651/22
Kaçanik, 11.02.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **II (dytë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 11 Shkurt 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Betim Shala-LDK, Ekrem Livoreka-AAK dhe Arben Thaqi-OJQ. Në takim mori pjesë Jeton Lika-OSBE.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse, Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e II-të (dytë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 11 Shkurt, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Hartim i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ? Procesverbalin e mbledhjes se I-rë (parë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se I-rë të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 14.01.2022 / Lënda : 01Nr.60/01-895/22.

2. Hartim i Planit të Punës së Komitetit për Komunitete

z.Ekrem Livoreka, Hapi diskutimin lidhur me planin e punës së Komitetit për komunitete, nëse keni ndonjë propozim.

z.Arben Thaqi, E kam analizuar planin e punës së Komitetit për Komunitete,të mëhershëm. Gjendja e Pandemisë Covid-19 , duhet të qëndroj , pasi që jemi ende në gjendje pandemie. Strategjia e përmbushjes së planit, nuk është shumë e rëndësishme sepse nuk kemi komunitet tjetër në komunën tonë. Mendoj të futet një pikë tjetër, p.sh. turizmi malor, ose mbrojtja e ambientit dhe e lumenjëve, që është shumë me rëndësi, për shkak të ndotjes që është bërë. Komuniteti bujqësisë dhe i blektorisë, është me rëndësi. Këto pika i shoh të nevojshme të përfshihen në plan të punës së Komitetit për Komunitete. Edhe çështje tjetër është, të ketë më shumë komunikim ndërmjet këshillit të prindërve dhe këshillit të nxënësve.

z.Betim Shala, Unë pajtohem me propozimet e Arben Thaqit.

Znj.Lejla Muhaxheri-Çaka, Edhe unë pajtohem me propozimet e Arben Thaqit, lidhur me mbrojtjen e lumenjëve nga ndotja.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Edhe unë pajtohem me Arben Thaqin, lidhur me mbrojtjen e lumenjëve nga ndotja.

Znj.Arta Avdiu, Edhe pastrimi i varrezave duhet të jetë në planë të punës.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Do të hy edhe kjo pikë në planë të punës.

z.Arben Thaqi,Ambienti ishte i përfshirë më pak. Te shëndetësia, mund të hy edhe shëndeti mental. Te arsimi, gjithëpërfshirja e nxënësve në shkolla.Strategjinë për përmbushjen e planit , e kisha heq nga ky plan.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Vazhdojmë sipas radhës me pikët e planit të punës së Komitetit për Komunitete. Pika 1,Gjendja me Pandeminë Covid-19 , në komunën e Kaçanikut;

z.Arben Thaqi, -Rastet me Covid-19. Mësimdhënësit dhe nxënësit e infektuar.Përkrahja materiale, tash qytetarët nuk janë të izoluar, mund të hiqet, si aktivitet dhe të futet “Pasojat psikologjike nga Covid-19”. Afati kohor i këtij aktiviteti,shkurt-dhjetor.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, 2.Strategjia e përmbushjes së planit të Komitetit për Komunitete.

z.Arben Thaqi, Strategji duhet të ketë, por aktiviteti të ndryshohet. Të hy si aktivitet: “Të organizohet një tryezë me komitete për komunitete ,të komunave tjera, për shkëmbim të përvojave” dhe “Trajnim me anëtarët e Komitetit për Komunitete”. Afati kohor :shkurt-qershor.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Pika 3.Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut.

z.Betim Shala, Unë mendoj që afati kohor lidhur me këtë aktivitet të jetë shkurt-qershor.

z.Arben Thaqi, Unë mendoj shkurt-dhjetor.Si aktivitet të hiqet “profilet e mësimdhënësve” dhe të hy “braktisja e shkollës nga nxënësit”.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, pika 4, Të drejtat e qytetarëve të komunës së Kaçanikut.- mbetet si pikë në plan. Pika 5, Ndarja e granteve dhe subvencioneve për OJQ.

z.Arben Thaqi, Të ndryshohet monitorimi i ndarjes së granteve dhe subvencioneve , të futet: Ndarja e granteve dhe zbatueshmëria e ligjit për sponzorizim.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Pika 6, Aktivitete rinore në komunën e Kaçanikut- mbetet në plan të punës. Pika 7, .Sporti në komunën e Kaçanikut- mbetet në plan të punës. Pika 8, Rastet sociale në Komunën e Kaçanikut- mbetet në plan të punës. Pika 9, Gjendja e bizneseve në komunën e Kaçanikut- mbetet në plan.


z.Arben Thaqi, Në këtë pikë, tek aktivitetet, të futet edhe turizmi malor.

Kryesuesi i Komitetit,Ekrem Livoreka, Pika 10, Krijimi i hapësirave për parkingje- mbetet në planë të punës.A jeni të pajtimit që ky plan i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022, ti përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022 , u shtrua në votim dhe i njehti u votua njëzëri .Me këtë konstatojmë që :

Plani i Punës së Komitetit për Komunitete, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim

z.Ekrem Livoreka, Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim e mbylli mbledhjen e dytë të Komitetit për Komunitete, në ora 12:10.

Procesmbajtës;
Arbnora Kuka



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

